



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 3717 prot.

Himarë, më 25.05 . 2026

Lënda: Dërgohet për miratim projekt vendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.39, datë 20/12/2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në varësi të Bashkisë Himarë”.

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË



Himarë

Në bazë të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54, ligjit nr.44/2015 “Kodi procedurave administrave të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projekt vendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.39, datë 20/12/2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në varësi të Bashkisë Himarë”.
- Relacionin mbi projekt vendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.39, datë 20/12/2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në varësi të Bashkisë Himarë”.
- Kopje të vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.39, datë 20/12/2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në varësi të Bashkisë Himarë”.

KRYETARI
Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTRIA JURIDIKE

Nr. 3717/prot.
1

Himarë, më 25 05 . 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 33, Datë 25/05/2026

PËR

**“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.39, DATË 20/12/2024 “PËR
KRIJIMIN E NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE HIMARË SI
INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË HIMARË”**

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreut III nenet 10-20, kreut IV nenet 20-29, kreut VII nenet 39-40 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat standarte të miratimit të buxhetit”, VKM -në nr.328, datë 31.5.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” (i përditësuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

VENDOSI:

Në vendimin nr.39, datë 20/12/2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në varësi të Bashkisë Himarë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në pikën 1: “Të miratojë krijimin e NSHP Himarë (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë), si institucion në varësi të Bashkisë Himarë.Detyrat kryesore institucionale e funksionale të këtij instiucioni do të jenë si më poshtë vijon:” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës (n) shtohen shkronjat (nj), (o) dhe (p) me këtë përmbajtje:

nj. Të administrojë dhe mirëmbajë vendet e depozitimit të mbetjeve të ngurta dhe inerteve në territorin e Bashkisë Himarë, si dhe të organizojë sistemimin, grumbullimin, transportimin dhe trajtimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

o. Të ketë të drejtë të lidhë marrëveshje bashkëpunimi, kontrata shërbimi apo forma të tjera bashkëpunimi me subjekte publike ose private për depozitimin, administrimin, transportin, përpunimin, riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe inerteve.

p. Të zbatojë masa dhe politika për reduktimin e ndotjes nga mbetjet e ngurta dhe inertet, si dhe për përmirësimin e administrimit mjedisor dhe rehabilitimin e zonave të ndotura në territorin e Bashkisë Himarë.

2. Ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETARI

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 3717/prot.
2

Himarë, më 25.05 . 2026

RELACION:

MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.39, DATË 20/12/2024 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE HIMARË SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË HIMARË”

Të nderuar Këshilltarë!

Ky projektvendim paraqitet për miratim me qëllim përmirësimin e eficiencës administrative dhe funksionale të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë (NSHP), në funksion të administrimit më efektiv të mbetjeve të ngurta dhe inerteve në territorin e Bashkisë Himarë..

I. Baza ligjore

Ky projekt-vendim mbështetet në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, veçanërisht nenet 34, 40, 41, 45 dhe 55.
- Ligjin nr.9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu III nenet 10–20, kreu IV nenet 20–29 dhe kreu VII nenet 39–40.
- Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Ligjin nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”.
- Ligjin nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i përditësuar.

- Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat standarde të miratimit të buxhetit”.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.39, datë 20.12.2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë si institucion në varësi të Bashkisë Himarë”.

II. Qëllimi dhe arsyetimi i projekt vendimit

Rritja e vazhdueshme e aktivitetit ndërtimor, zhvillimi urban dhe fluksi i shtuar i popullsisë gjatë sezonit turistik kanë sjellë rritje të konsiderueshme të volumeve të mbetjeve të ngurta dhe inerteve, duke krijuar nevojën e domosdoshme për organizimin dhe menaxhimin e strukturuar të vendeve të depozitimit, sistemimit dhe trajtimit të tyre.

Aktualisht, administrimi i inerteve dhe mbetjeve të ngurta përballlet me problematika që lidhen me:

- depozitimet e pakontrolluara në hapësira publike;
- ndotjen mjedisore dhe dëmtimin e territorit;
- kostot e larta operative për pastrimin dhe rehabilitimin e zonave të ndotura;
- mungesën e një strukture të specializuar për menaxhimin dhe monitorimin e këtij procesi;
- nevojën për koordinim më efikas me subjektet private dhe operatorët ekonomikë.

Për këtë arsye, propozohet zgjerimi i kompetencave të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë, duke i ngarkuar asaj administrimin dhe mirëmbajtjen e vendeve të depozitimit të mbetjeve të ngurta dhe inerteve, organizimin e sistemimit, grumbullimit, transportimit dhe trajtimit të tyre, si dhe krijimin e mundësisë ligjore për bashkëpunim me subjekte publike dhe private në funksion të përpunimit, riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Këto ndryshime synojnë:

- rritjen e eficiencës në administrimin e mbetjeve dhe inerteve;
- uljen e kostove të ndërhyrjeve emergjente dhe rehabilituese;
- parandalimin e depozitimeve të paligjshme;
- përmirësimin e standardeve mjedisore dhe të higjienës publike;
- krijimin e një sistemi më të organizuar dhe të kontrolluar për menaxhimin e mbetjeve;
- rritjen e kapaciteteve administrative dhe operacionale të Bashkisë Himarë në funksion të mbrojtjes së territorit dhe mjedisit.

Efektet e pritshme nga miratimi i këtij projektvendimi:

- përmirësim të administrimit të mbetjeve të ngurta dhe inerteve;
- reduktim të ndotjes mjedisore;
- rritje të eficiencës së shërbimeve publike;
- përmirësim të kontrollit dhe monitorimit të territorit;
- rritje të kapaciteteve operacionale të NSHP Himarë;

- krijimin e një sistemi më të organizuar dhe funksional për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Bashkisë Himarë.

Projektvendimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore, menaxhimin financiar dhe administrimin mjedisor, si dhe me nevojat konkrete të Bashkisë Himarë për administrimin eficient të shërbimeve publike.

DREJTORIA JURIDIKE
DREJTORI
Ardit Muhametaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Himarë, më 24.12.2024

Nr. 8060 Prot.

VENDIM

Nr. 39 Datë 20.12.2024

PËR

KRIJIMIN E NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE HIMARË SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË HIMARË

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin 9936 datë 26.08.2008 "Për menaxhimin e sistemimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore" ligjin Nr 10296 datë 08.07.2010. "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave "Mbi procedurat standarte të miratimit të buxhetit", të ndryshuar, mbi njoftimin për transfertën e pakushtëzuar e përgjithëshme dhe sektoriale, për vitin 2024, VKM 503, datë 01.08.2024 Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore",

Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 20/12/2024, pasi shqyrtoi materialin e sjellë nga administrata, e miratoi me 20 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Të miratojë krijimin e NSHP Himarë (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë), si institucion në varësi të Bashkisë Himarë. Detyrat kryesore institucionale e funksionale të këtij instiucioni do të jenë si më poshtë vijon:
 - a. të admnistrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë të Bashkisë Himarë mbi tokë dhe nëntokë në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim.
 - b. të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme.
 - c. të instalojë dhe mirëmbajë infrastrukturën dhe sinjalistikën rrugore.
 - d. të instalojë dhe mirëmbajë ndricimin publik në Bashkinë Himarë.
 - e. të kryejë efarëdolloj tjetër aktiviteti, që nuk bie në kundërshtim e që lidhet direkt apo indirekt me përmbushjen e detyrave institucionale e funksionale.
 - f. të kryejë detyrat që i ngarkohen nga njësia e qeverisjes vendore në kuadër të funksioneve të përcaktuara në ligj.
 - g. ti propozojë Bashkisë Himarë përmirësimin e politikave të administrimit të hapësirave publike
 - h. plazhet publike
 - i. pastrimi
 - j. kanalet vaditëse
 - k. kopshte çerdhe, shkolla
 - l. sheshet dhe hapësirat publike
 - m. furnizimi i shkollave me lëndë ngrohëse
 - n. të informojë qytetarët për shërbimet që ofrojnë, për procedurat dhe për politikatat që zbatohen
2. Të ardhurat e gjeneruara të kalojnë 100% për Bashkinë e Himarës. Të ardhurat xhirohen në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë Himarë, çdo muaj mbi akt rakordimet me Degën e Thesarit dhe raportohen në Bashkinë Himarë.

4. Të miratojë buxhetin dhe organigramën me numrin e përgjithshëm të punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë në 77 punonjës sipas lidhjes Nr. 1, pjesë e buxhetit të NSHP.
5. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit sipas lidhjes së pagave aneksi 2 pjesë e buxhetit të NSHP, bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Efektet financiare fillojnë nga data 1 janar 2025, dhe do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin ushtrimor.
7. Shtesat dhe paksimet të pasqyrohen në ndryshime të vendimit të këshillit bashkiak "Për Buxhetin e Bashkisë Himarë të vitit 2025"
7. Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi të identifikohen dhe të ndiqen procedurat për kalimin kapital të asetëve, ambienteve pajisjeve të domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale, institucionale të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.
8. Në mbështetje të pikës 4 të këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë të miratojë menjëherë strukturën dhe rregulloren e funksionimit të brendshëm të NSHP Himarë.
- 9 Ngarkohet Drejtoria e Financës, Planifikimit të Buxhetit dhe Integritimit Evropian, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve dhe NSHP Himarë për zbatimin e këtij vendimi.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) pas marrjes së ligjshmërisë.

KRYETARI

Dhimitër Kapa

